



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

6152/1
Nr. /Prot.

Tiranë, më 24/11/2022

URDHËR

NR. 624 , DATË 24/11/2022

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 7502/2, DATË 30.11.2016, "PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 110/2018, "Për Noterinë", i ndryshuar, të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 "Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit",

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 2, të Urdhrit nr. 7502/2, datë 30.11.2016, si vijon:

Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a. Z. ~~Blendi Shkollari~~, specialist, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- b. Znj. ~~Admira Boriçi~~, specialiste, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- c. Znj. ~~Admira Boriçi~~, specialiste, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ndryshimin e pikës 3, të Urdhrit nr. 7502/2, datë 30.11.2016, si vijon:

Arkiva merret në dorëzim me procesverbal dhe në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Degën Vendore të Noterisë Shkodër.

Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Shkodër znj. **Admira Boriçi**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

3. Ndryshimin e pikës 4, të Urdhrit nr. 7502/2, datë 30.11.2016, si vijon:

Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noteres znj. **Admira Boriçi**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noteres Rudina Hajredini.

4. Ndryshimin e pikës 5, të Urdhrit nr. 7502/2, datë 30.11.2016, si vijon:

Marrjen e masave nga Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës si dhe ish-noteres Rudina Hajredini.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

